



Universiteti Publik "KADRI ZEKA" Public University	
13.09.2024	
07	1885

UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjiilan.net tel: 0280390112

Thirrje për mobilitet të studentëve në Universitetin e PH Zug në Zvicër

Bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes UKZ dhe PH Zug për mobilitetin e studentëve, do të bëhet përzgjedhja e studentëve për vizitën studimore në Universitetin PH ZUG në Zvicër, e cila u mundëson 15-të studentëve nga Universiteti "Kadri Zeka" të jenë pjesë e këtij shkëmbimi.

Mobilitetet ndihmojnë studentët e UKZ-së të ngriten profesionalisht dhe të përfitojnë nga eksperiencat e ndryshme që ata marrin nga vizitat e shumë vendeve dhe Universiteteve Ndërkombëtare, prandaj aplikoni për të pasur një eksperiencë në Universitetin e PH Zug në Zvicër.

Mobiliteti i studentëve të UKZ-së në Zvicër do të realizohet në muajin dhjetor 2024, paraprakisht studentët e përzgjedhur të UKZ-së do të presin studentët nga PH Zug në muajin tetor 2024, ku përgjatë një (1) jave do të ketë aktivitete të ndryshme.


Përzgjedhja e studentëve tanë do të bëhet duke ju përmbajtur kritereve të mëposhtme:

1. Gjithsej 15 studentë do të jenë pjesë e programit për vitin 2024;
2. Mobiliteti zgjat një (1) javë;
3. Gjithsej do të pranohen 15 studentë, të gjithë nga Fakulteti i EDUKIMIT;
4. Nëse nuk do të mbushet numri vetëm nga studentët e Fakultetit të EDUKIMIT atëherë mund të pranohen edhe studentë nga Fakultetet e tjera, por jodomosdoshmërisht duhet të plotësohet numri prej 15 studentëve.
5. Nga intervista do të përzgjedhet një studentë lider i grupit që do të jetë përgjegjës për grupin gjatë gjithë vizitës studentore.
6. Studentët duhet të flasin gjuhën angleze, përparësi llogaritet edhe gjuha gjermane (do të testohen për gjuhë në ZMJ);
7. Studentët duhet të kenë aftësi komunikimi, do të kenë pune në grupe, të jenë të përkushtuar për programin dhe t'i përmbahen programit, të punojnë paraprakisht me studentët e PH Zug dhe t'i përshtaten kërkesave të ZMJ për realizimin e programit;
8. Të jetë i/e gatshme të mirëpresë në shtëpi një studentë nga PH Zug për një javë;
9. Të prezantoj ndonjë ide të rëndësishme për diskutim gjatë procesit të intervistës, me të cilën do të merret gjatë udhëtimit në PH Zug të Zvicrës?
10. Të marrë pjesë në të gjitha grupet punuese në UKZ, gjatë vizitës së studentëve nga PH Zug;

Të gjithë studentët e interesuar, duhet të lajmërohen tek Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar e UKZ-së, deri me datën 20/09/2024, nga ora 09:00-16:00 CET dhe duhet të kenë me vete:

- o Vërtetimin që janë studentë;
- o Certifikatën e notave dhe
- o Kopjen e pasaportës me vlefshmëri minimale të afatit deri me 31/12/2024.

Suksese të gjithë studentëve.


Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka
Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte